



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 35, datë 30.03.2026

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SUBJEKTIT ZHVILLUES PËR OBJEKTIN:
“HOTEL BAMBOO”, ME 1, 6-7 KATE MBI TOKË DHE 2-4 KATE NËNTOKË”, ME
VENDNDODHJE NË BASHKINË SARANDË

Në mbështetje të neneve 27, 28, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit” i ndryshuar, nenit 13/1 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Znj. Gerilda Hadëri, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e subjektit zhvillues për objektin: “Hotel Bamboo”, me 1, 6-7 kate mbi tokë dhe 2-4 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë, miratuar me Vendimin Nr. 40, datë 25.09.2024 të Këshillit Kombëtar të Territorit, nga subjekti zhvillues Z. Aleks Rexhaj dhe Znj. Agime Rexhaj, në subjektin zhvillues Znj. Gerilda Hadëri.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHIJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



ADELAIDA ROKA

Nënshkruar më datë 15/04/ 2026